VENDIM
Nr.783, datë 10.11.2011

PËR PROCEDURAT E NDARJES SË TË ARDHURAVE TË TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA ME NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore.

2. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin (komunë, bashki) të taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

3. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 18 (tetëmbëdhjetë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 82 (tetëdhjetë e dy)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).

4. Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave, si dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha